

FTESË

Një konkurs për Sheshin Skenderbej. Eshhtë koha. Kam ngurruar vijimësisht pasi ky shesh ngjall gjithnjë dilema të mëdha sa herë i vijmë vërdallë për të vënë dorë mbi të. Jam shpresëplotë që ftesa për konkurs do të tërheqë vëmendjen e zgjojë dëshirat e atyre që mund t'i japin zgjidhje dilemave lidhur me të ardhmen e kësaj hapësire ku ka sfiluar historia e fashizmit, komunizmit dhe demokracisë, ku janë organizuar manifestime të pashembullta për të përshëndetur pushtuesit e pastaj për te mbuluar me lule çlirimtarët, për të vajtuar Stalinin e për te mikpritur Hrushovin, për të treguar dashuri të skajshme për Cu En Lain në kohën e dashurisë së madhe me Kinën dhe për të shfryrë urrejtje ideologjike ndaj qytetarëve që mësynë ambasadat e huaja pas rënies së Murit të Berlinit, për të kremtuar hareshëm vdekjen e Perëndisë me nxjerrjen jashtë ligjit të fesë e dinamitimin e dymijë e disa qindra kishave dhe adhuruar ringjalljen e Zotit me pritjen solemne të Gjon Palit të Dytë, për të afirmuar antiimperializmin amerikan me turma të pafundme manifestuesish të organizuar dhe për të mbuluar me puthjet e një turme oqeanike veturën e Sekretarit Amerikan të Shtetit, për të vajtuar me det zie vdekjen e diktatorit Enver Hoxha në prill të vitit 1985 dhe për të tërhequr zvarrë monumentin e tij në shkurt të vitit 1991...

Një hapësirë pa formë të përcaktuar ku vejevijmë papushim e rregull makinat apo një shesh i kufizuar në dispozicion të këmbësorëve? Një udhëkryq kaotik ku s'ndalon dot asnjë dekimë apo një piacë ku takohen të gjithë? Një shesh ku sundojnë fantazmat e ngrehinat e të shkuarës apo ku ngrihen volume të reja arkitektonike që ridimensionojnë jehonën e historisë? Dhe më tutje akoma, ç'do të ndodhë me fasadën e Pallatit sovietik të Kulturës e me kollonadën e tij? Po godina e Muzeut Historik a mund të programohet ndryshe për t'u kthyer në një hapësirë të re publike që tërheq kryeqytetasit dhe vizitorët e Tiranës? Ç'mund të jenë volumet e reja që propozohen në masterplanin e qendrës në rast se filli i arsytimit na bën ti pranojmë? A e pranon historia e sheshit rritjen e përmasës së gjelbër brenda tij siç le të kuptohet masterplani?

Këto pikëpyetje mbeten të ngritura mbi sheshin ku është shkruar historia e shtetit shqiptar, i cili s'ka mbushur ende 100 vjet. Këtyre pikëpyetjeve duhet të na ndihmojnë t'u japim përgjigje sy që e shohin Sheshin Skënderbej nga jashtë, sy të pagjakosur me historinë tonë të jetuar dhe të stërvitur në beteja të

tilla konceptuale, sy pa paragjykime për ç'ka ka lënë e shkuara e as frikë nga ç'mund të lindë e ardhmja në këtë hapësirë sfiduese. Qyshse sheshi ka mbetur peng i dilemave e i makinave, hapësirë e pajetueshme në degradim të vazhdueshëm, bëjnë përshtypje siluetat e qytetarëve, të moshuar e familjarë me fëmijë të vegjël, të cilët ulen pasditeve në kufijtë e tij me të dalë dimri dhe ngjajnë si spektatorë që, prej 17 vjetësh, presin të ndodhë diçka në boshllëkun e arenës. Çfarë do të ndodhë?

Ju ftoj ta gjejmë së bashku.

Edi Rama

Kryetari i Bashkisë